



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 239, Datë 22.09.2022

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES OSSH SH.A.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “f” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike me nr. 1539 prot., datë 13.09.2022 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.”,

Konstatoi se:

- ERE me vendimin e bordit nr. 257, datë 21.12.2020 ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSSH sh.a.
- Në pikën 1.2 dhe pikën 2 të Programit të Pajtueshmërisë parashikohet se: *OSSH sh.a. përcakton, Zyrtarin e Pajtueshmërisë, i cili më pas miratohet me vendim të Bordit të ERE-s.*
- Duke qënë se në zbatim të përcaktimeve si më sipër OSSH sh.a. nuk kishte caktuar zyrtarin e pajtueshmërisë, ERE me vendimin nr. 18/2022 vendosi që brenda 30 ditëve pune nga marrja e këtij vendimi dhe pas miratimit nga organet drejtuese të shoqërisë, OSSH sh.a. duhet të përcillte për miratim në ERE kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, duke përfshirë si pjesë integrale dhe kriteret për zgjedhëse të tij.
- Në vijim, duke u bazuar te kërkesa e OSSH sh.a., e depozituar përpara përfundimit të këtij afati, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 69, datë 11.04.2022 vendosi të zgjasë afatin për depozitimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë deri më 30.06.2022.
- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë me shkresën nr. 289/3 prot., datë 21.04.2022 dhe me shkresën nr. 289/4, datë 23.06.2022 i është rikujtuar detyrimi për të depozituar në afat dokumentacionin e kërkuar. Rezulton që edhe pas përfundimit të afatit OSSH sh.a. nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Nisur nga nevoja për të emëruar Zyrtarin e Pajtueshmërisë, i cili do të monitorojë dhe raportojë mbi zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë u vlerësua që ERE, me nismën e saj të hartojë kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, së bashku me kriteret e përzgjedhjes së tij, dhe të fillojë procedurën për miratimin e saj.
- Ky dokument është hartuar duke u bazuar dhe në procedura të mëparshme të ngjashme, si Kontrata për ofrimin e shërbimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Trasmetimit, OST sh.a. si dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë së OST-së të gazit natyror.
- Në këtë dokument përcaktohen dhe detyrat/shërbimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë, i cili ka për detyrë monitorimin e zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë dhe për raportimin e këtij zbatimi sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, dhe në vetë Programin e Pajtueshmërisë.
- Në kontratë gjejnë parashikim në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke përfshirë shërbimet që duhet të ofrojë zyrtari, të drejtat e Zyrtarit, të drejtat dhe detyrimet e OSSH sh.a., pagesat dhe detyrimet financiare për shërbimet e Zyrtarit, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve. Përsa i përket pagesës së Zyrtarit të Pajtueshmërisë, ajo duhet të caktohet nga OSSH sh.a.
- Kjo kontratë hyn në fuqi në datën kur ajo nënshkruhet nga palët dhe mandati i Zyrtarit të Pajtueshmërisë fillon ditën tjetër të punës pas nënshkrimit. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej 3 (tre) vitesh nga data e nënshkrimit.
- Në Shtojcën 1, përfshihen kriteret përzgjedhëse të Zyrtarit të Pajtueshmërisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI